

VENDIM
Nr.1350, datë 3.10.2008

PËR MIRATIMIN E RAPORTIT PËR GJENDJEN E MJEDISIT NË SHQIPËRI,
PËR VITET 2005, 2006 E 2007

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 69 të ligjit nr.8934, datë 5.9.2002 “Për mbrojtjen e mjedisit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e raportit për gjendjen e mjedisit në Shqipëri, për vitet 2005, 2006 e 2007, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha